



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË
DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2025**

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 MASHTI në vitin 2025 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 3,287,630€ në kategori ekonomike jo adekuate, si rezultat i planifikimit jo të mirë buxhetor dhe pagesave të kryera nga thesari me vendime gjyqësore.
- B2 Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale ishte nënvlerësuar për 1,140,570€, për shkak të mos regjistrimit të tyre në regjistrat e përkatës të pasurisë. Po ashtu kishte mbivlerësuar pasuritë për vlerën 11,407€, pasi të njëjtat ishin regjistruar në SIMFK dhe në e-pasuri.
- B3 Detyrimet kontigjente në PFV nuk janë paraqitur në mënyrë të saktë, duke rezultuar në nënvlerësim prej 2,360,167€ dhe mbivlerësim prej 2,349€. Kjo ka ndodhur si pasojë e klasifikimit të gabuar të dy lëndëve, të cilat janë trajtuar si obligime të papaguara në vend se të paraqiteshin si detyrime kontigjente. Si rrjedhojë, detyrimet e papaguara janë mbivlerësuar për 2,127,636€, ndërsa detyrimet kontigjente janë nënvlerësuar për të njëjtën vlerë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në tetë pagesa në vlerë totale prej 225,570€ ne kemi vërejtur që ato nuk ishin të nënshkruar nga zyrtari i autorizuar.
- B4 MASHTI nuk kishte mbajtur regjistrat e menaxhimit të kontratave përmes platformës së e-prokurimit.
- B5 Në 15 pagesa në vlerë totale prej 380,410€ kishte vonesa në pagesa nga shtatë ditë deri 11 muaj, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.
- B6 Në tri pagesa në vlerë të përbashkët 100,472€ kishte vonesa në liferimin e mallrave përtej afatit të përcaktuar në kontratë, të cilat variojnë nga 10 deri në 24 ditë vonesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministre në detyrë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2025, ka shpenzuar 95,209,988 € apo 91% të buxhetit final. Çështjet e identifikuar që kanë ndikuar te opinion i pasqyrave financiare janë klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, nënvlerësimi i pasurive, nënvlerësimi i detyrimeve kontigjente si dhe mbivlerësimi i obligimeve të papaguara.

Ndërsa çështjet tjera që kanë të bëjnë me konkluzionin e pajtueshmërisë dhe menaxhimin financiar janë, vonesa në pagesën e faturave, vonesa në liferimin e mallrave, dobësi në pranimin e mallrave, menaxhimi i kontratave jo përmes e-prokurimit si dhe menaxhimi i pasurive.

Po ashtu, procesi i raportimit në Ministri ishte shoqëruar me mangësi, të cilat u reflektuan në përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), ku u identifikuan gabime që më pas u korrigjuan pas sugjerimeve të auditimit.

Vlen të theksohet se për vitin 2025, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 1,816,753€ përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore. Nga kjo vlerë, 401,811€ ishin nga investimet kapitale, 939,262€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe 475,680€ nga subvencionet dhe transferet. Këto pagesa janë kryesisht të lidhura me kontratën kolektive.

Ky raport ka rezultuar me 9 rekomandime, prej tyre një është rekomandim i ri dhe tetë të përsëritura. Nga rekomandimet e vitit të kaluar, MASHTI kishte zbatuar shtatë prej 15 rekomandimeve të dhëna.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18, pika 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike kërkon që shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për Planin Kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të siguroj që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në vitin 2025, MASHTI ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 3,287,630€ në kategori ekonomike jo adekuate. Këta janë vërejtur si në vijim:

- Nga buxheti i MASHTI-it për paga jubilarë dhe shujta, Thesari ka ekzekutuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore në vlerë prej 1,816,753€, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre, nga kategoria e investimeve kapitale ishin kryer pagesa në vlerë prej 401,811€, nga mallrat dhe shërbimet 939,262€ si dhe nga subvencione 475,680. Për këto pagesa, ne kemi testuar

15 pagesa në vlerë 772,632€ të cilat për nga natyra i takonin kategorisë paga dhe mëditje.

- Si rezultat i planifikimit jo të mirë, MASHTI kishte regjistruar shpenzime në kode jo adekuate në vlerë 1,470,877€. Prej tyre, nga investimet kapitale ishin regjistruar shpenzime në vlerë 1,055,207€ të cilat për nga natyra i takonin kategorisë mallra dhe shërbime. Ndërsa prej kategorisë së mallrave ishin regjistruar shpenzime në vlerë 415,670€ të cilat për nga natyra i takonin kategorisë investime kapitale.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, pavarësisht kërkesës së MASHTI-it që mjetet për këto projekte të buxhetohen në kategoritë adekuate. Po ashtu, edhe keqklasifikimi nga mallra dhe shërbime ishte rezultat i buxhetimit jo të drejtë, por edhe tërheqjes së mjeteve nga ana e thesarit si rezultat i vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve, duke ofruar kështu informata jo të sakta. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Nënvlerësimi i pasurive kapitale

Gjetja Sipas nenit 16 të rregullores MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare, zyrtari i pasurisë jo financiare do të jetë përgjegjës për evidentimin përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përgjithshëm të pasurive me të gjitha informatat që kërkohen në dispozitat e kësaj rregullore dhe ligjeve të tjera në fuqi. Zyrtari i pasurisë jo financiare do t'i regjistrojë në mënyrën e duhur të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se pasuria është në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore.

Gjatë auditimit të PFV për vitin 2025, kemi konstatuar që MASHTI kishte nënvlerësuar pasuritë në vlerë 1,140,570€, për shkak të mos regjistrimit të tyre në regjistrat përkatës të pasurisë, për rastet në vijim:

- Furnizimi me pako laboratorike dhe inventar për shkollat e ndryshme në vlerë 801,271€;
- Blerja e dy veturave zyrtare në vlerë 78,468€;
- Blerja e smartboard në vlerë 13,800€;
- Pajisje tjera në vlerë 33,742€;
- Ndërtimi i çerdhes së parafabrikuar modulare në Fushë Kosovë në

vlerë 206,578€; si dhe

- Në dy raste, pasuria e blerë nuk ishte regjistruar komplet duke rezultuar në nënvlerësim prej 6,710€.

Tutje ne kemi identifikuar dobësi tjera si:

- Në dy raste pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ishin regjistruar dy herë, njëherë në regjistrin e SIMFK-së si dhe në e-pasuri, duke e mbivlerësuar në vlerë prej 11,407€.
- Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës në Universitetin e Mitrovicës, pasuria ishte e regjistruar si investim në vijim edhe përkundër faktit se i plotëson të gjitha kushtet të regjistrohet si pasuri e rregullt, madje edhe të aplikohet zhvlerësimi i saj.
- Blerja e Softuerit - Gjuha Shqipe dhe Kompjuteri, është kategorizuar në mënyrë të pasaktë, duke ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit në kategorinë përkatëse. Në vend se të zhvlerësohej për shtatë vite, ishte zhvlerësuar për pesë, dhe si rrjedhojë e këtij trajtimi të gabuar, pasuria do të kishte ende jetë të mbetur apo vlerë prej 136,000€.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme si dhe mos sigurimit të marrëveshjeve të nënshkruara nga komunat përkatëse për MASHTI-in për bartjen e pronësisë së tyre. Për këtë, Ministria duhej t'i regjistronte ato si pjesë e pasurive të saj deri në momentin e marrëveshjeve për dorëzim/bartje të tyre.

Kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportet e viteve paraprak dhe menaxhmenti i Ministrisë nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për ta adresuar edhe përkundër zotimit në planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive nga ana e MASHTI-it për pasuritë të cilat janë shpërndarë nëpër shkolla dhe mos siguri i marrëveshjeve për bartjen e tyre në regjistrat e shkollave (në Komunat përkatëse) që kanë kontrollin dhe pronësinë, dobësive në regjistrim si dhe mos regjistrimi i pasurive kanë ndikuar që vlera e tyre të mos jetë e saktë duke e nënvlerësuar pasurinë e Ministrisë.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete për të siguruar që të gjitha pasuritë e saj janë regjistruar saktë dhe drejtë në regjistra përkatës. Po ashtu, pasuritë e gatshme (pajisjet e ndryshme) që blihen për shkolla përkatëse të regjistrohen direkt në regjistrat e shkollave-komunave pas sigurimit të marrëveshjeve të nënshkruara nga të dyja palët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Paraqitje jo e saktë e detyrimeve në pasqyrat financiare

Gjetja

Neni 6 i Rregullores 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton se " Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Gjatë testimeve tona, kemi identifikuar pasaktësi në raportimin e detyrimeve

kontigjente, duke rezultuar në nënvlerësim prej 2,360,167€ dhe mbivlerësim prej 2,349€. Njëkohësisht, detyrimet e papaguara janë mbivlerësuar për 2,127,636€, Këto janë vërejtur si në vijim:

- Në raportin e obligimeve të papaguara për vitin 2025, kemi vërejtur se janë përfshirë lëndë që i përkasin detyrimeve kontigjente aktive në vlerë 2,127,636€, të cilat janë klasifikuar dhe prezantuar gabimisht si obligime të papaguara, megjithëse natyra e tyre është detyrime kontigjente dhe jo obligime aktuale për pagesë, duke nënvlerësuar detyrimet kontigjente dhe mbivlerësuar detyrimet e papaguara për këtë vlerë.
- Te programi Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Ferizajt dhe Universiteti i Mitrovicës, detyrimet kontigjente nuk ishin prezantuar në mënyrë të plotë në PFV të Ministrisë. Kjo ka bërë që ato të nënvlerësohen për vlerën 222,582€.
- Në një rast në Institutin e Historisë detyrimi kontigjent është i nënvlerësuar për vlerën e kontestit 9,949 për faktin se në regjistër ishte prezantuar me vlerë zero; dhe
- Në një rast detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 2,349€ në Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimin Profesional, pasi që lënda ishte paguar dhe Ministria nuk kishte detyrim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrës ligjore dhe zyrës së financave në kuadër të MASHTI-it si dhe dobësive në kontrole lidhur me mbajtjen e evidencave të plota dhe raportimit të saktë të tyre në PFV.

Ndikimi

Shpalosja jo e plotë dhe jo e saktë e detyrimeve kontigjente dhe obligimeve të papaguara rezulton në mbivlerësimin dhe njëkohësisht në nënvlerësimin e tyre, duke ndikuar negativisht në besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare.

Rekomandimi B3

Ministri, duhet të siguroj një koordinim dhe komunikim të duhur në mes zyrave ligjore të të gjitha njësive vartëse dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente dhe atyre të papaguara të mbahen të saktë dhe të azhurnuara me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Raporti i pranimit të mallit nuk ishte i nënshkruar nga personi/zyrtari i autorizuar

Gjetja

Sipas Nenit 23, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF, pranimi i mallit/shërbimit bëhet nga zyrtari ose komisioni i autorizuar, ndërsa raporti i pranimit duhet të dorëzohet si pjesë e dokumentacionit për procedimin e pagesës. Ndërsa sipas Nenit 22 të së njëjtës rregull, raporti i pranimit të mallit është një nga dokumentet bazë në procedurat e përgjithshme për procesimin e pagesave

Raporti i pranimit të mallit i gjeneruar nga SIMFK, për pagesat në vlerë mbi 1,000€ do të duhej të nënshkruhej nga personi/zyrtari i autorizuar. Megjithatë, në Agjencinë për Aftësim Profesional dhe Arsimim për të Rritur në tetë pagesa në vlerë totale prej 225,570€ ne kemi vërejtur që përkundër raporteve të komisioneve të pranimit të nënshkruara, dokumenti i gjeneruar prej SIMFK-së për këto pagesa nuk ishte nënshkruar nga zyrtari i autorizuar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme, përkatësisht mungesës së verifikimit të plotë të dokumentacionit para procedimit të pagesës.

Ndikimi

Mungesa e nënshkrimit nga personi/zyrtari i autorizuar për pagesat që kanë vlerë mbi 1,000€ dobëson kontrollet e brendshme në fazën e pranimit të mallrave dhe shërbimeve dhe mund të ndikojë në procesimin e pagesave pa verifikim të plotë.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, në mënyrë që raporti i pranimit të mallit të nënshkruhet nga personi autorizues, para procedimit të mëtejshëm të dokumentacionit për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja

Sipas paragrafi 70.24. pika (f) të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik, funksionet e menaxherit të kontratës kërkojnë që për secilën kontratë "Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se në pesë procedura të audituara, menaxherët e kontratave kishin përgatitur planin e menaxhimit të kontratave mirëpo menaxhimi i tyre nuk bëhej përmes platformës elektronike të e-prokurimit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me përdorimin e modulit e-prokurimi si dhe mungesës së trajnimit të duhur për ta.

Ndikimi Mungesa e njohurive të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit e-prokurimi për menaxhimin e kontratave, ndikon që menaxhmenti të mos merr informata të mjaftueshme, në kohën e duhur në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj trajnimin e menaxherëve të kontratave në mënyrë që menaxhimi i kontratave të bëhet përmes modulit të e-prokurimit, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39.1 i LMFPP, përcakton që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 15 raste në vlerë totale prej 380,410€, kemi vërejtur se MASHTI nuk kishte paguar faturat brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në pagesa ishin nga shtatë ditë deri në 11 muaj përtej afatit ligjor. Prej këtyre faturave, 12 ishin nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 271,580€ si dhe tri nga investimet kapitale në vlerë 108,830€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontroleve joadekuate në ekzekutimin e pagesave si dhe mos përcjellja me kohë e faturave në zyrë të financave.

Ndikimi Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve rrit rrezikun që Ministria të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbartimore të cilat mund të rezultojnë me shpenzime shtesë duke e rënduar buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që të eliminohen vonesat e paarsyeshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Vonesa në liferimin e mallrave

Gjetja Sipas nenit 2 të kontratës, por edhe kushteve të veçanta të kontratës, definojnë qartë afatin e liferimit të mallit, i përcaktuar në ditë

Gjatë testimit të pagesave, kemi vërejtur se në tri pagesa në vlerë të përbashkët 100,472€ kishte vonesa në liferimin e mallrave përtej afatit të përcaktuar në kontratë, të cilat variojnë nga 10 ditë deri në 24 ditë vonesë. Këto vonesa ishin te kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Arsyeja e vonesave ishte menaxhimi jo i duhur i kërkesave për furnizime

dhe dukuria e mos respektimit të rregullave për procesim të urdhër blerjeve në kohën e duhur.

Ndikimi

Vonesat e gjata të liferimit të mallrave duke mos i respektuar afatet e përcaktuara me kontratë si dhe mos respektimi i rregullave për procesimin e urdhër blerjeve me kohë ndikon në realizimin e kontratave si dhe pamundëson aplikimin e penaleve për ditët e vonesave.

Rekomandimi B6

Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 177,840,461€, pasurive jokapitale është 2,124,212€, si dhe e stoqeve 650,532€.

Çështja B7 - Mos bartja e pronësisë së shkollave të ndërtuara te komunat përkatëse

Gjetja

Sipas nenit 13, pikës 1 dhe 2 të rregullores MF- Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim.

Edhe gjatë vitit 2025, shkollat dhe objektet arsimore të cilat ishin përfunduar nuk ishte bartur pronësia tek komunat përkatëse, edhe pse këto objekte i plotësonin kriteret për dorëzimin dhe regjistrimin e tyre si objekte në përdorim në komunat përkatëse. Megjithatë, bartja e pronësisë nuk kishte ndodhur dhe ato mbaheshin ende në regjistrat e MASHTI-it si investime në vijim. Për këto, ne kemi testuar dy raste si në vijim:

- Ndërtimi i shkollës fillore Krushë e Madhe, në vlerë 1,667,482€; si dhe
- Ndërtimi i objektit arsimor Dobresh Viti, në vlerë 123,205€.

Kjo vonesë e bartjes së pronësisë së pasurive nga MASHTI tek komunat përkatëse është një dukuri që ka vazhduar për vite me radhë. Edhe përkundër nënshkrimit të marrëveshjeve për bartjen e pronësisë me komunat përkatëse, ky proces ende nuk ishte finalizuar.

Ndikimi

Mos bartja e pronësisë së pasurive nga MASHTI tek komunat përkatëse, ka efekt negativ në menaxhimin e tyre nga komunat që në realitet e kanë kontrollin mbi to.

Rekomandimi B7

Ministri duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje të pronësisë te Komunat përkatëse. Po ashtu, në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mangësi në menaxhimin e pasurive jo financiare**Gjetja**

Sipas rregullores MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 24, pika 1, pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare. Tutje, neni 6, i rregullores thekson se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Gjatë auditimit është konstatuar se:

- Në Universitetin e Gjilanit dhe Gjakovës ishte formuar komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare dhe ishte kryer inventarizimi, mirëpo nuk ishte bërë harmonizimi i regjistrave. Te Gjilani është vërejtur se e njëjta pasuri ishte e regjistruar njëkohësisht në SIMFK-së dhe në sistemin e-pasuria, kurse te Gjakova pasuritë e blerë gjatë vitit 2025 nuk ishte regjistruar dhe as evidentuar në proces të inventarizimit.
- Gjatë analizimit të regjistrave të e-pasurisë kemi vërejtur se MASHTI nuk kishte aplikuar zhvlerësimin e pasurive të blera gjatë vitit në programet e: Agjencisë për Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, Universitetit të Gjilanit, Univerisitetit të Gjakovës, Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë, Universitetit të Pejës si dhe të Universitetit të Prizrenit.
- Në Universitetin e Mitrovicës, pasuria nën 1,000€ ishte raportuar në PFV nga regjistrat e brendshëm dhe jo nga regjistrat e e-pasurisë, për faktin që, sipas zyrtarëve, pasuria në sistemin e-pasuria ishte e regjistruar vetëm gjatë vitit 2025.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të kontrolleve jo të duhura lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Ndikimi

Raportimi jo i plotë dhe jo i saktë i gjendjes së pasurive të prezantuara në PFV, si rezultat i mos përfshirjes së pasurive nga të gjitha njësitë vartëse në kuadër të MASHTI-it si dhe mos kryerja e harmonizimit të regjistrave sipas kërkesave të rregullores përkatëse ka ndikuar në nënvlerësim/mbivlerësimin e pasurive në PFV

Rekomandimi B8

Ministri duhet të zbatoj një proces të rregullt dhe të dokumentuar të inventarizimit të pasurisë jo financiare, koordinim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet të gjitha njësive vartëse (programeve) gjatë raportimit për PFV, duke garantuar që ndryshimet e konstatuara të reflektojnë saktë në gjendjen reale të pasurive jokapitale, dhe se vlera e tyre e paraqitur në PFV është e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 Gabimet e identifikuara në prezantimin e PFV

Gjetja

Gjatë rishikimit të PFV është identifikuar një mospërputhje dhe prezantime jo i saktë si:

Te Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - Daljet e parasë së gatshme- nuk ishte përfshirë vlera e klauzolës së investimeve 1,000,000€ tek buxheti fillestar i shpenzimeve kapitale.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për ti korigjuar PFV, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime korigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PFV e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^o	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	99,963,750	104,998,457	95,209,988	82,149,554	68,013,651
Grante Qeveritare - Buxheti	95,575,369	97,758,353	92,347,859	79,743,417	65,920,068
Financimi përmes huamarrjes	1,000,000	1,000,000	0	0	0
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,000,000	1,000,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,324,058	975,743	1,130,059	968,848
Të hyrat vetanake	2,388,381	2,388,381	1,121,130	896,081	625,955
Donacionet vendore	0	25,821	7,238	0	7,220
Donacionet e jashtme	0	1,501,845	758,018	379,997	491,561

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 5,034,707€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të Qeverisë, të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve.

Në vitin 2025, MASHTI ka shpenzuar 91% të buxhetit final apo 95,209,988€, me një përmirësim prej 10% krahasuar me vitin e kaluar.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	99,963,750	104,998,457	95,209,988	82,149,554	68,013,651
Pagat dhe mëditjet	23,455,877	24,916,853	24,778,182	22,596,897	21,293,577
Mallrat dhe shërbimet	14,856,412	16,926,863	12,782,814	12,901,360	10,828,658
Komunalitë	1,590,459	1,796,049	1,324,384	1,127,131	1,160,090
Subvencionet dhe transferet	19,198,948	24,195,239	22,930,209	28,917,676	18,945,381
Investimet Kapitale	40,862,054	37,163,453	33,394,399	16,606,490	15,785,945

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,460,976€. Kjo rritje ishte me vendime të Qeverisë për rritjen në paga dhe shtesa prej 0.5 njësi të koeficientit. Shpenzimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 2,070,451€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte 76%;
- Buxheti final për komunalitë ishte rritur për 205,590€. Shpenzimi nga buxheti për këtë kategori ishte 74%;
- Buxheti për kategorinë e subvencione dhe transfere ishte rritur për vlerën 4,996,291€, nga i cili ishin shpenzuar 95%. Rritja e buxhetit në këtë kategori kishte të bënte me subvencionin për blerjen e librave shkollor dhe pajisjeve të tjera shkollore, ku prej grantit qeveritar ishin rritur për vlerën 4,937,416€, prej të hyrave nga viti i kaluar 2,000€ si dhe nga donacionet 56,875€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,698,601€, si rezultat i mos shpenzimit të fondeve për shkak të vonesave në iniciimin e procedurave të prokurimit. Shpenzimet krahasuar me buxhetin final ishin 90%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MASHTI në 2025 ishin në vlerë 3,100,041€. Ato kanë të bëjnë me participimet, tarifat për akreditim, taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	3,260,093	3,260,093	3,100,041	2,729,550	2,364,692
Të hyrat jo tatimore	3,260,093	3,260,093	2,958,999	2,707,017	2,352,586
Të hyrat tjera	0	0	141,042	22,533	12,107

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 të MASHTI-t ka rezultuar me 15 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, shtatë rekomandime ishin zbatuar dhe tetë ende nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që brenda një afati të arsyeshëm të zhvillojë procedurat e rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore për plotësimin e pozitave që mbahen me ushtrues detyre.	Rekomandimi është implementuar pasi që MASHTI gjatë vitit 2025 kishte zhvilluar procedura të rekrutimit.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të forcojë kontrollet dhe mekanizmat e mbikëqyrjes për të siguruar që shpërndarja e fondeve publike të bëhet në përputhje me kriteret dhe vendimin e qeverisë, duke siguruar që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për tua pamundësuar përfitimin individëve të cilët nuk kualifikohen për këtë qëllim.	MASHTI gjatë vitit 2025 kishte krijuar mekanizma për implementimin e rekomandimit duke mos lëshuar asnjë pagese pa konfirmimet e shkollave.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.	Nuk është zbatuar rekomandimi pasi që edhe gjatë testimit të mostrave në vitin 2025 kemi hasur vonesa në liferimin e mallrave.	Nuk është adresuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që të eliminohen vonesat e paarsyeshme.	Nuk është zbatuar rekomandimi pasi që edhe gjatë testimit të mostrave në vitin 2025 kemi hasur vonesa në pagesa.	Nuk është adresuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur në rate të keqklasifikimit.	Nuk është adresuar
6.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurohet që avancet për projekte kapitale mbyllen brenda vitit fiskal siç parashihet me rregulla ligjore dhe të monitorohet procesi i avanceve të dhëna për projektet e caktuara. Po ashtu, të specifikohet qartë arsyetimi i tyre për punët e përfunduara që mbulojnë avancet deri në përfundim të vitit fiskal, në mënyrë që të njëjtat mos të mbesin të hapura për vitet në vijim.	Rekomandimi është implementuar pasi që MASHTI gjatë vitit 2025 kishte dërguar tri lëndë në Avokaturën e Shtetit për inkasimin e avanceve të hapura dhe në një rast është bërë inkasimi i t avancit të hapur.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj trajnimin e menaxherëve të kontratave në mënyrë që menaxhimi i kontratave të bëhet përmes modulit të e-prokurimit, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi vërejtur se është përgatitur plani i menaxhimit të kontratave mirëpo menaxhimi i kontratave nuk është bërë përmes platformës e-prokurimi.	Nuk është adresuar

8.	Investimet kapitale	Ministria duhet të siguroj që të gjitha procedurat e prokurimit publik, për kontratat me vlerë të parashikuar të kontratës mbi 500,000€ të përgatisin dhe publikojnë njoftimin paraprak, për të siguruar transparencë për OE dhe mundësinë e AK-ve të zbatojnë afatet e shkurtuara pa pasur nevojë për aprovim të procedurave të përshpejtuara.	Nga mostrat e testuara nuk ka pasur raste të ngjashme	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt kapital të hartohet dhe zbatohet plani ekzekutiv përpara nisjes së zbatimit, me qëllim të shmangies së nevojës për aneks kontrata dhe punë shtesë, si dhe për të garantuar realizimin e projekteve sipas buxhetit të planifikuar.	Gjatë vitit 2025 nga mostrat e testuara nuk ka pasur raste të ngjashme	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj mekanizma adekuat në forcimin e kontrolleve në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve për të siguruar përmbushjen e afateve, detyrimeve kontraktuale dhe realizimin e projekteve brenda dinamikës së planifikuar. Ndërsa për avancet e hapura të sigurojë që OE i ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj ministrisë.	Gjatë vitit 2025 nga mostrat e testuara nuk ka pasur raste të ngjashme.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Ministri duhet të ndërmerri veprime konkrete që të gjitha pasuritë të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të regjistrohet ose të barten me të gjitha procedurat formale në regjistrat e Komunave. Po ashtu, pasuritë e gatshme (pajisjet e ndryshme) që blihen për shkolla përkatëse të regjistrohen direkt në regjistrat e shkollave-komunave pas sigurimit të marrëveshjeve të nënshkruara nga të dyja palët.	Gjatë testimit kemi vërejtur se nuk ka filluar zbatimin i rekomandimit	Nuk është adresuar
12.	Pasuritë	Ministri duhet të zbatojë një proces të rregullt dhe të dokumentuar të inventarizimit të pasurisë jo financiare, koordinim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet të gjitha njësive vartëse (programeve) gjatë raportimit për PFV, duke garantuar që ndryshimet e konstatuara të reflektojnë saktë në gjendjen reale të pasurive jokapitale, dhe se vlera e tyre e paraqitur në PFV është e plotë dhe e saktë.	Gjatë testimit të mostrave për vitin 2025 kemi vërejtur se rekomandimi nuk ishte adresuar	Nuk është adresuar
13.	Pasuritë	Ministri duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje të pronësisë të Komunat përkatëse. Po ashtu, në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunave.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur në pasuri të cilat nuk janë bartur në komunat përkatëse	Nuk është adresuar

14.	Detyrimet Kontigjente	Ministri, duhet të siguroj një koordinim dhe komunikim të duhur në mes zyreve ligjore të të gjitha njësive vartëse dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen saktë.	Nuk ka filluar zbatimi	Nuk është adresuar
15.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që janë ndërmarrë veprimet e duhura që Komiteti i Auditimit të Brendshëm të jetë i plotë dhe funksional, si dhe përbërja e tij të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NJAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.	Gjatë vitit 2025 është formuar Komiteti i Auditimit.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Burbuqe Idrizi Ukaj, Udhëheqëse e ekipit



Albana Kadriu, Anëtare e ekipit



Granita Zenelaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>MASHTI është pajtuar pjesërisht. B1a Nënprogrami -IBCM- Furnizim me paisje të IT-se në vlerë 22,405.00 Euro IBCM nuk është pajtuar me gjetjen me arsyetimin: Procedura e rregullt e prokurimit është inicuar dhe është ndarë në 2 kategori, sepse IBCM nuk ka pasur fonde të mjaftueshme të kategoria e mallrat e shërbimet për këtë tender:</p> <p>a) Mallra dhe shërbime, ku janë përfshirë kompjuterë për zyre në shumë më të vogël se 1000 euro: dhe</p> <p>b) Kapitalet, ku janë përfshirë kompjuterët për funksionalizimin e laboratorit, të cilët në planifikim kanë qenë mbi 1000 euro.</p> <p>Gjate fazës së vlerësimit të ofertave, operatori ekonomik fitues, çmimin për kompjuterët për laborator (i cili është parapar të kushtoj mbi 1000 euro) e ka ofruar me cmim me të ulët se 1000 euro. Ne jemi interesuar që të anulojmë procedurën e prokurimit dhe kemi dërguar kërkesë për sqarim në KRPP. Sipas ligjit dhe rregullores së prokurimit, rasti i lartpërmendur nuk kategorizohet në arsyet e listuara për anulim të tenderit, dhe rrjedhimit ky tender ka vazhduar procedure.</p> <p>Te bashkangjitur gjeni kerkesen zyrtare nga IBCM per KRPP per anulimin e tenderit dhe pergjigjen nga KRPP per kerkesen tone.</p>	<p>E gjetura qëndron, për faktin se në raport ne kemi theksuar edhe përpjekjet e MASHTI-it që disa projekte të financohen/buxhetohen të kategoria mallra dhe shërbime, mirëpo fakti që kjo nuk ka ndodhur dhe shpenzimet (keq klasifikimet) janë pjesë e PFV-ve të MASHTI-it, sipas standardeve të auditimit duhet të paraqiten në Raportin e auditimit-it të OB-së ku ka ndodhur shpenzimi. Po ashtu, kjo çështje do të adresohet edhe në Raportin Vjetor të Buxhetit të Qeverisë.</p> <p>Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.</p>
Vonesa në liferimin e mallrave	<p>B6.a Universiteti i Prizrenit ka një rast që ka të bëjë me "Furnizim me licenca SMU" të datës 24.09.2025, i cili është vlerësuar se ka pasur vonesë në liferimin e mallrave. Më poshtë po paraqesim sqarimet</p>	<p>Lidhur me komentit për B6.a, e gjetura mbetet pasi sipas kontratës Furnizim me licenca të SMU - Sistemit të Menaxhimit Universitar dhe mirëmbajtja e tij, të Neni 2 Koha e përfundimit, përcakton se 2.1 Afati</p>

tona lidhur me çështjen e ngritur, si dhe arsyet pse konsiderojmë se kjo gjetje nuk qëndron:

1.Lloji i kontratës - Në këtë rast kemi të bëjmë me një kontratë kornizë për furnizim me shërbime dhe jo me kontratë për blerje të njëhershme të mallrave. Duke marrë parasysh natyrën e saj, konsiderojmë se trajtimi i kësaj kontrate sipas metodologjisë së aplikueshme për furnizim me mallra nuk aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

2.Natyra e shërbimit - Nuk kemi të bëjmë me dorëzim fizik të mallrave, por me ofrim të vazhdueshëm të shërbimeve softuerike, që përfshijnë aksesin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e licencave, të cilat rinovohen në baza mujore. Për këtë arsye, pagesa për këtë shërbim realizohet në formë parapagimi, në përputhje me praktikën e këtij lloji të shërbimeve.

3.Pranimi i shërbimit - Si dëshmi, bashkëngjism aktivizimin e shërbimit të datës 03.09.2025, në të cilën datë, përmes faturës së pranuar nga operatori ekonomik, është dërguar edhe numri i licencës për vazhdimin e shërbimit në sistem. Pra, në këtë datë shërbimi ka qenë aktiv dhe i përdorshëm. Regjistrimi i pranimi në sistem është pjesë e procedurës administrative të pagesës dhe nuk paraqet pranim fizik të mallrave, si në rastet e furnizimeve të njëhershme.

4.Kohëzgjatja e urdhërblerjes - Në kontratat kornizë, në përputhje me kërkesat ligjore për menaxhimin e kontratave, mjetet zotohen për të gjithë periudhën e kontratës, ndërsa urdhërblerjet gjenerohen për periudhën e mbetur të vitit fiskal. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një shërbim esencial me pagesë mujore fikse, pa të cilin funksionimi nuk është i mundur. Gjithashtu, sipas planit të menaxhimit të kontratës, pika "II. Progresi i kontratës", është e përcaktuar që furnizimi me licenca realizohet sipas nevojës (1, 3, 6, 12, 24 apo 36 muaj). Rrjedhimisht, lëshimi i urdhërblerjes për periudhë të caktuar paraprake nuk përbën

kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Kjo për faktin se Urdhërblejra është nxjerr me dt 10.07.2025 ndërsa liferimi është kryer me dt 03.09.2025.

Lidhur me komentën për B6.d, e gjetura mbetet pasi edhe sqarimet e ofruara nga MASHTI, tregojnë që operatori nuk ka ofruar pajisjet konform atyre të kontraktutara. Si rezultat kemi pasur vonesa, madje për ditët e vonuara sipas kontratës do të duhej të aplikohesh një penalitet i barabatë me 0.25% në ditët e vonuara të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

vonesë, por një veprim administrativ për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit.

Si përfundim i këtij sqarimi, dëshirojmë të theksojmë se “vonesa në liferim” mund të konsiderohet vetëm në rastet kur mungon ofrimi i shërbimit gjatë periudhës së parapaguar. Në rastin konkret, shërbimi ka qenë aktiv dhe i ofruar në mënyrë të vazhdueshme, prandaj kjo situatë nuk përbën vonesë, por një menaxhim të rregullt dhe të planifikuar të kontratës.

B6.d Programi IBCM nuk pajtohet me gjetjen lidhur me vonesën në liferimin e mallrave për pagesën Furnizim me pajisje tjera të Teknologjise Informative Për IBCM sipas kontratës me nr.97950-25-7155-1-2-1/C73, ju njoftojmë se bazuar në raportin e menaxherit të kontratës arsyeja pse kjo pagesë nuk është paguar brenda afatit rjedh nga nënshkrimi i kontratës është sepse operatori Ekonomik “AWA” SH.P.K produktin e pikes 34 “Air Conditioner Remote Controller” nuk e ka dorëzuar sipas specifikimeve teknike, dhe është dashur të pritët deri në dorëzimin e tij në përputhje me specifikimet.

<p>Mangësi në menaxhimin e pasurive jo financiare</p>	<p>Programi IBCM në lidhje me vërejtjen e mosaplikimit të zhvlerësimit për vitin 2024. Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë ka filluar funksionimin si institucion publik në vitin 2024, i cili përfaqëson vitin e tij të parë operacional. Të gjitha asetet, pajisjet dhe mobiljet janë blerë ekskluzivisht për nevojat e funksionimit fillestar të institucionit, sipas procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2024. Duke theksuar se pjesa më e madhe e aseteve janë inicuar me procedura të prokurimit nga gjysma e dytë e vitit 2024, efekti i zhvlerësimit për këtë periudhë është i kufizuar për shkak të kohës së shkurtër të përdorimit. Gjithashtu, pajisjet janë të reja dhe të mbuluara nga garancitë e prodhuesit, duke bërë që vlera e tyre kontabël të jetë në përputhje të plotë me koston e blerjes gjatë vitit të parë të përdorimit. Në këtë kontekst, mosaplikimi i zhvlerësimit për vitin 2024 konsiderohet i arsyeshëm, duke marrë parasysh:</p> <ul style="list-style-type: none"> •se institucioni është në vitin e parë të funksionimit; •se asetet janë vënë në përdorim kryesisht në gjysmën e dytë të vitit. <p>Duke u bazuar në rrethanat e lartpërmendura, kërkohet me respekt rishikimin e këtij konstatimi dhe mbetemi të hapur për çdo sqarim shtesë që mund të kërkohet.</p>	<p>E gjetura qëndron, për faktin se rregullorja MF - NR. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 22, Zhvlerësimi i pasurisë jo financiare, përcakton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. 2. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore. Pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes. <p>Arsyetimi i MASHTI-it se, Kolegji Publik Ndërkombëtar i Mitrovicës ka filluar funksionimin si institucion publik në vitin 2024 dhe se asetet janë blerë në gjysmën e dytë të vitit 2024 dhe se janë në garancion nuk e liron që pasuritë e saj të zhvlerësohen sipas kërkesave të rregullorës së pasurisë siç është përkrahur më lartë.</p> <p>Arsyetimet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar, prandaj e gjetura qëndron e pandryshuar.</p>
---	--	---

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
METODI PËR SHËNIMIN E KONTROLIT			
KODI I SHËNIMIT			
Episodi Çka Obj. Ushq.	Shifra e kodit Class. Code	No. Prot. Ser. No.	Titulli i Shënimit No. Page
03	44	776	1 + DËSHMI



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS - MINISTARTVO OSBAZOVANJA I NAUKE - MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE	
DALJE	
Niveli i sig.	01
Detajli i datimit	130526
No. Prot./No.	1978
No. i list./No. i list.	
Përcaktim / Përcaktim / Përcaktim	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës /
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet, ndërsa komentet dhe dëshmitë i gjeni të bashkangjitura;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Hajrulla Çeku, Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Data: 13.05.2026, Prishtinë.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁰, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Nga kategoria e investimeve kapitale, ishin realizuar 23 pagesa në vlerë 1,386,232€ që për nga vlera individuale e pajisjeve dhe natyra e tyre, këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, si në vijim: Furnizim me pajisje për shkollat e arsimit parauniversitar, pako laboratorike si dhe inventar për çerdhe në vlerë 1,032,802€; Furnizim me pajisje të TI-së në Universitetin e Pejës në vlerë 5,000€; Furnizim me pajisje të TI-së në Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë 22,405€; si dhe Pesë pagesa në vlerë në vlerë 326,025€ të cilat ishin realizuar sipas nenit 40 të LMFPP, i takonin kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Pagesa të realizuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve që duhej të klasifikoheshin si investime kapitale dhe paga e mëditje, ishin nëntë pagesa në vlerë 617,780€, si në vijim: Dy pagesa në vlerë 415,670€ të cilat kishin të bënin me hartim dhe mbikëqyrjen e projekteve i takonin kategorisë së investimeve kapitale; si dhe Shtatë pagesa në vlerë 202,080€ të cilat ishin realizuar sipas nenit 40 të LMFPP, i takonin kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Po ashtu, nga kategoria subvencione dhe transfere janë realizuar tri pagesa në vlerë prej 244,527 €, të cilat për nga natyra i takonin kategorisë paga dhe mëditje si dhe investime kapitale, siç janë: Dy pagesa në vlerë prej 126,475 €, të realizuara sipas nenit 40 të LMFPP, i takonin kategorisë së pagave dhe mëditjeve; si dhe Një pagesë në vlerë prej 118,052 €, e realizuar sipas nenit 40 të LMFPP, i takonte kategorisë së investimeve kapitale.
- ⁶ Paisje kompjuter dhe lloptop dhe Paisje tjera te Teknologjise Informative
- ⁷ Sipas dokumenteve burimore detyrimet kontigjente në Universitetin e Ferizajit ishin 119,521€ kurse të prezantuara në PVF janë 108,714€. Kurse në Universitetin e Mitrovicës ipas dokumenteve burimore detyrimet kontigjente ishin 59,065€ kurse të prezantuara në PVF janë 52,135€
- ⁸ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.